

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA –SUHAREKË OPSTINE SUVA REKA	
---	---	---

Komisioni për për mbajtjen e dëgjimeve publike për kornizën afatmesme buxhetore dhe qarkoren buxhetore të komunës së Suharekës për vitin 2027-2029

PROCESVERBAL

MBI MBAJTJEN E DËGJIMIT PUBLIK ME QYTETARË

I mbajtur më datë 20/05/2026, në SHFMU “Drita” në fshatin Gelancë, Komuna e Suharekës.

1. Baza Ligjore

Ky dëgjim publik është mbajtur në bazë të:

- Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 124, që garanton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrjen lokale;
- Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Statutit të Komunës së Suharekës;
- Dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë organizimin e dëgjimeve publike.

2. Të Pranishmit

Në këtë dëgjim publik morën pjesë përfaqësues të komunës, përfaqësues të fshatit dhe qytetarë të interesuar.

- Përfaqësuesi i Komunës: Anëtarët e Komisionit – Armend Krasniqi, Mensur Selimaj dhe Shqipron Bytyçi (Procesmbajtës)
- Banorë të fshatit Gelancë, gjithsej pjesmarrës **10 qytetarë**
 Meshkuj **10**
 Femra **0**

3. Rend Dite

1. Hapja e takimit dhe prezantimi i pjesëmarrësve;
2. Prezantimi i projekteve dhe planifikimeve komunale;

3. Diskutimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve;
4. Pyetje, komente dhe rekomandime nga qytetarët;
5. Përmbyllja e takimit.

4. Përmbledhje e Diskutimeve

Gjatë dëgjimit publik, qytetarët paraqitën kërkesat, shqetësimet dhe propozimet e tyre lidhur me infrastrukturën lokale, rrugët, ndriçimin publik, furnizimin me ujë, kanalizimin, shërbimet komunale, arsimin dhe çështje tjera me interes publik.

Përfaqësuesit e komunës dhanë sqarime lidhur me projektet aktuale dhe planifikimet për periudhën e ardhshme, duke u zotuar që kërkesat e qytetarëve do të shqyrtohen në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të komunës.

Kërkesat e qytetarëve prezent në këtë Dëgjim Publik:

1. **Lulzim Kukaj – qytetar i fshatit Gelancë**, kërkon rregullimin e rrugës “Gani Kukaj”, kanalizimin fekal në gjatësi prej 300 metra (me prioritet), trajtimin e impiantit të ujërave të zeza, po ashtu trajtimin e dy segmenteve të kanalizimit me gjatësi të përafërt prej 1 Km, rregullimi i infrastrukturës dhe rrugës në lagjen “Çadraku”, sanimi i rrugës tek ura e fshatit si dhe ndërtimin e shkollës së re të fshatit.
2. **Agim Trolli – qytetar i fshatit Gelancë**, kërkon rregullimin e urës “Daut Rexhepallari” në fshatin Gelancë

5. Konkluzionet dhe Rekomandimet

- Të evidentohen kërkesat prioritare të qytetarëve;
- Të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së projekteve në planifikimin buxhetor komunal;
- Të vazhdohet organizimi i dëgjimeve publike në të gjitha fshatrat dhe lagjet e komunës;
- Të njoftohen qytetarët për realizimin e rekomandimeve dhe projekteve të planifikuara.

6. Përmbyllja

Takimi përfundoi në ora 19:45. Ky procesverbal u hartua për nevoja administrative dhe evidencë zyrtare të komunës.

Pjesë integrale e këtij procesverbali është po ashtu dhe Lista e Pjesmarrjes, me evidencën e pjesmarrësve.

Hartuesi i Procesverbalit

Sh. B. N. T. N.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA



THE MUNICIPALITY OF SUHAREK

Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në GELANCË - SUHAREKË

Date: 20 05 2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nëshkrimi
1	LULZIM KUKAJ	GELANCË	
2	RAMË DEXHEPALLARI	— / —	
3	AGIM TROLLI	— / —	
4	AMIR KRASHNIQI	GELANC	
5	DUKIM KURTISHAJ	GELANC	
6	Hashim Kukaj	Gelanc	
7	VESEL GURI	GELANC	
8	ALIBAR PASHANICAJ	GELANC	
9	FERIT SHABANI	GELANC	
10	Kevin Shabani	Gelanc	
11			
12			
13			